

# “Ku e çuat Shpëtimin” – një aku

Promovohet libri

Nga Alûn Alimehmeti

QUEENS (New York)

Para disa ditësh u promovua libri “Ku e çuat Shpëtimin”, i autores Adelina Gina. Në këtë aktivitet të zhvilluar në restorantin “Rozafa” të Halit Shpuzës morën pjesë dhjetëra shqiptarë që prej vitesh punojnë e jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Autorja Gina tha se libri është një akuzë e fortë ndaj asaj dore të zezë që në Shqipërinë komuniste quhej “Sigurimi i Shtetit”, në Gjermaninë naziste “Gestapo” dhe në Rusi “KGB” (Agjensia e Intelgjencës dhe Sigurisë së Brendshme).

Librin Gina ia dedikon vëllait të saj, Shpëtimit, që u zhduk krejt papritur dhe në rrethanat tepër misterioze në moshën 23 vjeçare. Shpëtimi ishte një i ri me talent të madh letrar e artistik, por që fatkeqësisht nuk iu dha mundësia ta zhvillonte e ta përpunonte atë.

Në librim 78 faqësh, botuar nga shtëpia botuese “Kurti Publishing”, Gina flet shpesh për dhuntitë artistike të Shpëtimit, i cili që në moshë të re pati disa debutime të suksesshme në fushën e muzikës dhe të artit në përgjithësi. Por, autorja përqëndrohet më tepër në aftësitë e tij letrare, duke veçuar sidomos dramën “Armiqtë”, që Shpëtimi e shkroi në bangat e Fakultetit të Gazetarisë.

Kjo vepër e 21 vjeçarit të talentuar krijoi indinjatë të thellë në qarqet politike shqiptare të viteve ‘70-të. Në librin “Ku e çuat Shpëtimin” shënohet se “Armiqtë” nuk kishte asnjë lidhje me realizmin socialist dhe se vinte në pikëpyetje disa nga kryedogmat zyrtare të asaj kohe. Drama gjithashtu përkohet nga nota proteste kundër arrogancës së diktaturës. Autorja shënon se “Armiqtë” është e mbushur me tension, dhimbje, mëshirë për vuajtjet e njeriut nga dhuna shtetërore. Në të njëjtën kohë, ajo pasqyron tensionin që shpërtheu gjatë viteve ‘70-të, si pasojë e plenumeve IV, V, VI dhe VII. Në shkrimin e kësaj drame, shpjegon Gina, Shpëtimi po ndiqte këtë parim drejtues: artisti i bindet vetëm kërkesave të zërit të vet të brendshëm dhe përbuz dogmat dhe skemat zyrtare.

Sipas Skënder Shkupit, njërit prej folësve kryesorë të aktivitetit promovues, drama “Armiqtë” u pëlqye në fillim, por, papritur, ajo u ndalua në prag të shfaqjes. Këtu filluan edhe ditët e vështira për Shpëtimin.

“Megjithë njohjet që pat krijuar dhe simpatitë e përfuturara ndërmjet artistëve, shkrimtarëve dhe regjisorëve të njohur, veprimtaria krijuese e Shpëtimit shndërrohet në një vrapim me pengesa. Atë e pengojnë, përpiqen ta shmanjin, nuk i venë pjesët e tij në skenë. Me sa dukej, emri i tij ishte qarkuar me reth të kuq”, tha folësi në fjalë.

Diskriminimi artistik ndaj këtij talenti të ri ishte vetëm fillimi. Sipas skenarit zyrtar të shtetit, në vitin 1974, kur dramaturgu e gazetari i ri po kryente shërbimin ushtarak pas kryerjes së universitetit, ai hyri për t’u larë në lumë me një shok dhe nuk doli më.

Shteti shqiptar i servirir familjes Gina për vdekjen e birrit dhe vëllait të tyre këtë version: “Asfiksi mekanike me mbytje në ujë”. Sipas librit, dëshmi-



Autorja Adelina Gina diskuton për librin

tari i vetëm, shoku i Shpëtimit Dhorian Hanxhari, ishte i paqëndrueshëm dhe vetëkontradiktues në dëshmitë e tij për rrethanat e të ashtuquajturës mbytje. Për lëkundjen e “dëshmitarit” okular të ngjarjes, Gina shkruan: “Cila ishte e vërteta? Çfarë kishte ndodhur? Duke kërkuar, diçka zbulohet, diçka fshihet”. Motra e personazhit kryesor të librit, që në atë kohë ushtronte profesionin e gazetares, nuk e gëlltiti lehtë skenarin e shkruar nga shteti. Ajo nisi të interesohet vetë, “pa praninë e dëshmitarëve”, për rrethanat e zhdukjes së Shpëtimit. Gina i meri alibititë e paraqitura nga shteti dhe, përpiket që të vërë në provë vërtetësinë e secilës prej tyre, një nga një. Interesant është reagimi i babait të Shpëtimit dhe autores ndaj asaj se gjoja autopsia kishte konkluduar se stomaku i “të mbyturit” ishte mbushur me ujë. Mirëpo, kur mjekët paraqitën këtë “fakt” ndoshta nuk ua mente mendja se të afërmit e Shpëtimit kishin vajtuar në takim për të bërë disa pyetje sfiduese.

Në rreshtat vijues pasqyrohet qartë reagimi i mjekëve ndaj këmbënguljes së Ginës dhe babait të saj për të mos pranuar rezultatet e autopsisë:

“Thirrën mjekun ligjor. Ai tregoi se çdo organ ishte në rregull dhe se vetëm kishte pirë pak ujë. ‘Dëgjo’, i thashë, ‘sipas ligjeve të fizikës, kur hapen alveolat ose pihet tamam ose nuk pihet fare’. ‘Epo kishte pak lëng’, tha doktori, ‘mbase ishte ushqim’. Pyetje pas pyetjesh ai, doktori, filloi ta ndejfë veten keq, sa i kërkoi leje hetuesit të dilte jashtë se po i dhimbte koka. ‘Lëre’, i thashë, ‘është më i shqetësuar se unë i ati’.

Episodi më tronditës dhe ndoshta një nga predhat më fatale ndaj versionit zyrtar të vdekjes së Shpëtimit rrefehet në gjysmën e dytë të librit dhe ka të bëjë me zhvarrosjen e Shpëtimit.

Preteksti i zhvarrosjes, sqaron Gina në libër, ishte se ai do të vendosej në një varr me nënën, mirëpo në fakt kjo bëhej për t’u afruar sa më pranë të vërtetës.

Dëshmitar i procesit të zhvarrosjes ishte babai.

# zë e fortë ndaj Sigurimit të Shtetit

ri i Adelina Ginës



Pamje nga aktiviteti promovues

Për këtë ndodhi, Gina shkruan: "Varrëmihtësi ja kishin nisur punës. Babai i tronditur priste aty buzë varit. 'Një dorezë llastiku', tha një nga punëtorët, që po punonte tek varri, dhe e hodhi jashtë. Ishte nga ato që përdomin mjekët në operacione. Një tjetër nxori disa kopsa bakri dhe dy këpuçë njëra mbi tjetrën. Atë e varrosën me roba ushtarake. 'E paskërkan vënë zbatuar', mendoi vetëtimthi babai. Nuk donte ta pranonte se njeriu që ishte aty ishte i biri. 'Qënkërka më i shkurtër se Shpëtimi, ose më duket mua. Dy dhëmbët e përparm i mungojnë. Shpëtimi i kishte të gjithë, dhe i kishte si ruaza".

Ky është një ilustrim i rrethanave enigmatike të zhdukjes së 23 vjeçarit Shpëtimi Gina.

Këmbënguljen e autores në kërkim të së vërtetës e nxori në pah gjatë fjalës së tij edhe Shkupi. Në lidhje me këtë ai tha: "Nis një anabas i vërtetë i saj në kërkim të fakteve, të provave, të dëshmiave për të zbardhur një realitet të mbuluar me një vello të trashë. Ata rezistojnë, mbrohen, kërcënojnë. Por autorja-personazh nuk zbrapset, ajo e ka nisur luftën e saj për të nxjerrë të vërtetën në shesh pa pyetur për pasojat". Folësi në fjalë gjithashtu shpjegoi se kjo nuk ishte edhe aq e lehtë për një femër të re dhe pa përkrahje, kundër një qeverie të tërë që organizonte, mbështeste dhe maskonte terrorin institucional. Ndërsa folësi tjetër kryesor, Astrit Sula, tha se libri i Ginës, "Ku e çuat Shpëtimin", është një ilustrim i mirë i jetës artistike në Shqipërinë komuniste. Sula u shpjegoi të pranishmëve se Shpëtimi nuk ishte një djale i thjeshtë dhe i talentuar.

"Ai ishte një meteor që u shkëput shumë shpejt nga universi, e u shua përgjithmonë në ferrin e kuq, më të tmerrshëm se ferri i Dante Aligerit", tha Sula.

Pjesa finale e librit flet për ecejaket e Ginës për të vënë në skenë dramën "Armiqtë" pas rrëzimit të diktaturës në Shqipëri. Aludimet që nxjerrin në pah hezitimin e teatrit të Shqipërisë post-komuniste për të vënë në skenë këtë dramë nuk janë të pakta. Këto

hezitime, sipas Ginës, vërtetojnë se demokracia nuk kishte ardhur ende në Shqipëri, edhe pas rrëzimit të komunizmit.

Ginës iu desh ta mbante librin në vetvehte për gati tre dekada. "Jetova për 28 vite me këtë dhimbje dhe e nxorra tashti nga vetja sepse unë dhe shumë të tjerë si unë nuk duhet të heshtin për krimet e bëra nga pjesa më e erët e diktaturës, Sigurimi i Shtetit", tha Gina dhe më pas shtoi: "Shumë prej atyre që kryen krime barbare, krijuan procese falco dhe dënuan njerëz të pafajshëm kanë ardhur në Amerikë dhe kanë marrë dokumentet si të përdjekur politikë".

Për këtë arsye, shprehet autorja, përveç demaskimit të krimit ndaj Shpëtimin, libri shërben edhe si paralajmërim i fortë për lexuesin se shumë prej kriminelëve që kryen krime të shumta në Shqipërinë komuniste janë në mesin tonë edhe sot. "Shpresoja që të demoskoja anën më të zezë të atij vendi dhe doja që ta demoskoja sepse mendoj se kjo dorë ende nuk është prerë", tha Gina. Më pas ajo shprehu optimizëm për arrijtjen e qëllimit të botimit të librit. "Po i akuzoj hapazi dhe me emra personat që kryen krimet dhe që sot, me emra të tjerë dhe me mbështetje financiare, veprojnë përsëri dhe ende mbeten një kërcënim i madh për shoqërinë shqiptare".

## Saktësim

Në numrin e kaluar të "Illyria"-s (N0. 1141), në artikullin më titull "Poezia e Lleshanakut kapërcen Atlantikun", janë lënë jashtë emrat e përkthyesve të tjerë të librit "Afresk", me autore Luljeta Lleshanaku.

Përveç Henry Israelit, në përkthimin e këtij libri kanë bashkëpunuar: Joanna Goodman, Ukzenel Buçpapa, Noci Deda, Alban Kupi, Albana Lleshanaku, Lluka Qafoku, Shpresa Qatipi, Qazim Sheme, Daniel Weissbort dhe Luljeta Lleshanaku.